



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E POLICISË BASHKIAKE

Nr. 6989 prot.

Himarë, më 25.09. 2026

**NJOFTIM PËR RESPEKTIMIN E RREGULLAVE TË PASTËRTISË, QARKULLIMIT
DHE PËRDORIMIT TË HAPËSIRAVE PUBLIKE GJATË ZHVILLIMIT TË
PUNIMEVE TË NDËRTIMIT**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr. 89/2022, “Për Policinë Bashkiake”; VKM-së nr. 452, datë 26.07.2023, “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”; ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr. 4, datë 31.01.2020, “Për vendosjen e gjobave për shkeljet e kryera”, si dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe administrimin e mbetjeve, Drejtoria e Policisë Bashkiake njofton të gjitha shoqëritë ndërtuese dhe subjektet që kryejnë punime në territorin e Bashkisë Himarë se, me qëllim parandalimin e ndotjes dhe dëmtimit të rrugëve, shmangien e aksidenteve, garantimin e sigurisë rrugore dhe mbrojtjen e këmbësorëve e të përdoruesve të tjerë të rrugës, duhet të marrin masat e mëposhtme:

1. Pastrimi i mjeteve përpara daljes nga kantieri

Të gjitha automjetet dhe makineritë e ndërtimit duhet të pastrohen brenda territorit të kantierit përpara daljes në rrugë. Gomat, shasia dhe pjesët e jashtme të mjeteve duhet të jenë të pastra nga balta, betoni, inertet dhe materialet e tjera që mund të ndotin ose të dëmtojnë rrugën.

2. Mirëmbajtja e daljes së kantierit

Hyrja dhe dalja e kantierit, si dhe segmenti rrugor pranë tij, duhet të mbahen vazhdimisht të pastra. Në rast ndotjeje, subjekti duhet të kryejë menjëherë pastrimin e plotë të sipërfaqes rrugore, pa prituri ndërhyrjen e strukturave bashkiake.

3. Parkimi i mjeteve

Automjetet, makineritë e rënda, betonieret, pompat e betonit dhe pajisjet e tjera të punës duhet të parkohen brenda territorit të kantierit. Ndalohet parkimi ose qëndrimi i tyre:

- në rrugë dhe trotuare;
- në vendparkime publike;
- në hapësira të destinuara për parkimin e automjeteve të qytetarëve;
- në vende ku pengohet qarkullimi, shikueshmëria ose lëvizja e këmbësorëve.

4. Betonieret dhe pompat e betonit

Betonieret dhe pompat e betonit duhet të jenë në gjendje të rregullt teknike dhe të mos shkaktojnë rrjedhje betoni, ujërash me përmbajtje çimentoje, karburanti, vaji ose substancash të tjera.

Larja e tyre duhet të kryhet vetëm brenda kantierit, në një vend të përshtatshëm për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve. Ndalohet shkarkimi i ujërave të larjes ose i mbetjeve të betonit në rrugë, trotuare, kanale kulluese, pusetat e ujërave, mjedisin përreth apo në det.

5. Transporti i materialeve

Automjetet që transportojnë inerte, dhera, rërë, çimento ose materiale të tjera duhet të jenë të mbuluara dhe të siguruara, në mënyrë që ngarkesa të mos derdhet, shpërndahet ose krijojë pluhur gjatë qarkullimit. Mjetet nuk duhet të ngarkohen mbi kapacitetin e lejuar dhe duhet të respektojnë kufizimet ligjore për qarkullimin e mjeteve të rënda.

6. Mbetjet e ndërtimit

Materialet dhe mbetjet e ndërtimit duhet të depozitohen brenda kantierit, në vende të përcaktuara dhe të sigurta. Ndalohet depozitimi i tyre në rrugë, trotuare, sheshe, vendparkime, kanale, përrrenj, vijën bregdetare ose në çdo hapësirë tjetër publike. Largimi i mbetjeve duhet të kryhet rregullisht dhe vetëm në vendet e miratuara për këtë qëllim.

7. Hyrja dhe dalja e mjeteve nga kantieri

Hyrja dhe dalja e mjeteve nga kantieri duhet të organizohet në mënyrë të sigurt, pa penguar qarkullimin dhe pa rrezikuar këmbësorët apo përdoruesit e tjerë të rrugës. Kur dalja nga kantieri ka shikueshmëri të kufizuar ose krijon rrezik për qarkullimin, subjekti duhet të caktojë një punonjës për orientimin e mjeteve dhe garantimin e sigurisë gjatë hyrjes dhe daljes së tyre.

8. Mbrojtja e rrugëve dhe infrastrukturës publike

Subjekti ndërtues mban përgjegjësi për çdo dëmtim të rrugës, trotuarit, bordurave, pusetave, ndriçimit, sinjalistikës ose elementeve të tjera të infrastrukturës publike të shkaktuar nga veprimtaria e kantierit apo nga mjetet e tij.

9. Pluhuri, zhurma dhe materialet e shpërndara

Gjatë punimeve duhet të merren masa për kufizimin e pluhurit, zhurmës dhe shpërndarjes së materialeve jashtë kantierit. Materialet pluhurore duhet të mbulohen ose të lagen sipas nevojës, pa krijuar rrjedhje në rrugë.

Drejtoria e Policisë Bashkiake do të kryejë kontrole të vazhdueshme në terren. Në rast të konstatimit të shkeljeve të kërkesave të përcaktuara në këtë njoftim, ato do të dokumentohen dhe ndaj subjekteve përgjegjëse do të merren masa administrative, përfshirë vendosjen e gjobave, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kompetencave ligjore. Kërkohet marrja e menjëhershme e masave për zbatimin e kërkesave të mësipërme, si dhe informimi i drejtuesve teknikë, përgjegjësve të kantierit, nënkontraktorëve dhe drejtuesve të mjeteve.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

NË MUNGESË, ME URDHËR DHE ME DELEGIM

ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi

